



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par. 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 18 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna si dhe neneve 40, 41 dhe 64 par. 2 pika a) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 Kryetari i Komunes, nxjerr:

#### VENDIM

MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR PROJEKT – RREGULLOREN PËR  
VENDOSJEN, NDËRTIMIN DHE LARGIMIN E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME NË  
PRONËN PUBLIKE

#### Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, të publikohet në WebFaqen e Komunës dhe tabelen e shpalljeve:

Projekt- Rregullore për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike.

#### Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet në këtë Projekt Rregullore mund të dërgohen në Komisionin për hartimin e Propozim Rregullorës, më së largu deri më 14.02.2021.

#### Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në Webfaqën e Komunës.

INr. 351-3114

Lipjan, më 14.01.2021

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti

